


Nr. regj. 18209/2012



GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, gjyqtaria Azra Cakolli me procesmbajtësen Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Fatmir(Misin)Shurdhaj, nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 5, 6 dhe neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 25.07.2012 morri këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Fatmir(Misin)Shurdhaj, i lindur më 22.04.1968 në Banjë të Malishevës, me vendqëndrim në Lagjen "Dardania", rruga "Mustaf Venhari", nr. 7/6, Hyrja B, nr. 1, në Prishtinë, ka të kryer Fakultetin e Politikave ndërkombëtare dhe Diplomaci, zëvendës ministër i Punës dhe mirëqenies Sociale, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si zyrtarë i lartë publik, zëvendës ministër i Punës dhe mirëqenies Sociale, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31mars 2012, në Agjencinë kundër korrupsion, sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, -

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5, 6 e neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, andaj i shqiptohet

D Ë N I M

Me gjobë në shumë prej 2000(dymijë) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Paga bëhet në ndonjërin agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30(tridhjetë) ditësh. Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguajnë shumën prej nga 5 €, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën nr. 01-1827/2012 më datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartcekur për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke kërkuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se është informuar për deklarimin vjetorë të pasurisë përmes pikës kontaktuese, por menjëherë ka shkuar në udhëtim zyrtarë dhe ka harru të dërgoj aplikacionin në Agjenci deri më datë 31.03. 2012. Pas kthimit nga udhëtimi zyrtarë e ka deklaruar pasurinë gjykatës ia prezanton Vërtetimin me numër të protokollit 03/33598 të datës 03.04.2012, se ka deklaruar pasurinë. Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi të deklaratës së të pandehurit, vlerësimi të provave të tjera secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë pasi që më afatin e paraparë ligjor deri 31.03 2012, nuk ka bërë deklarimin e pasurisë ashtu si e parasheh ligji. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, andaj i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 18209/2012, më datë 25.07.2012

Gjyqtaria
Azra Gakolli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.

